

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 33544/08

Artan PERDEDA
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 11 tetor 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Pasi mori në konsideratë:

kërkesën (nr. 33544/08) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 2 korrik 2008 nga një shtetas shqiptar, z. Artan Perdeda (“kërkuesi”), lindur në vitin 1972 dhe banor në Fier, i përfaqësuar nga znj. E. Deshati, një avokate e cila e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për t’ia përcjellë kërkesën Qeverisë shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga agjentja e saj, znj. Alma Hicka, Avokate e Përgjithshme e Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Më 13 prill 2000, kërkuesi u mbajt në paraburgim për, *inter alia*, akuzën penale të vrasjes.
2. Më 26 dhjetor 2001, ai u lirua nga gjykata dhe u nxor nga paraburgimi. Pas apelimit të prokurorit, çështja u dërgua në gjykatë.
3. Pas një sërë dërgesash në gjykatë, më 10 tetor 2004, prokurori vendosi t’i ndërpriste procedurat ndaj kërkuesit.
4. Më 22 nëntor 2005, kërkuesi paraqiti një padi civile ku kërkonte 3,110,000 lekë (ALL, afërsisht 23,900 euro (EUR) në atë periudhë) për paraburgimin “e padrejtë” që vuajti nga data 13 prill 2000 deri më 26 dhjetor 2001 (622 ditë). Gjithashtu, ai kërkonte edhe një shpërblim prej 1,500,000 dëmin shkaktuar ndaj nderit dhe reputacionit të tij.
5. Më 16 mars 2006, Gjykata e Rrethit Fier (“Gjykata e Rrethit”) i akordoi kërkuesit një kompensim në shumën prej 311,000 lekë (afërsisht 2,400 euro në atë periudhë) për periudhën e paraburgimit të padrejtë prej 622 ditësh, duke e shpërblyer kërkuesin me 500 lekë për ditë. Gjithashtu, ajo i akordoi kërkuesit 300,000 lekë (afërsisht 2,330 lekë në atë periudhë) për dëmin jomonetar për sa i përkiste reputacionit të dëmtuar të kërkuesit. Gjykata, në mbështetje të provave të dhëna nga familjarët e kërkuesit, gjykoi se akuza ndaj kërkuesit kishte ngritur dyshime, në opinionin publik, se ai ishte *de facto* autor i krimit. Lidhjet që kërkuesi dhe familjarët e tij kishin dikur me fqinjët dhe të afërmit ishin shpëputur. Paraburgimi kishte dëmtuar reputacionin e kërkuesit dhe kjo ishte bërë pengesë që të krijonte një familje.
6. Kërkuesi apeloj vendimin. Ai parashtroi se Gjykata e Rrethit e kishte konsideruar pa të drejtë si të papunë, sepse ai punonte si emigrant i herëpashershëm në Greqi. Sipas kërkuesit, Gjykata e Rrethit do të duhej t’i kishte akorduar 5,000 lekë për secilën ditë të paraburgimit.
7. Më 30 janar 2007, Gjykata e Apelit Vlorë la në fuqi shumën e dhënë për paraburgimin “e padrejtë”. Gjykata e Apelit e rrëzoi shumën e dhënë në lidhje me reputacionin e kërkuesit, për

mungesë të provave. Ajo gjykoj se kërkuksi nuk mund të provonte se paraburgimi i tij kishte njoollatur reputacionin dhe nderin e familjes së tij, ose se ai etiketohej apo stigmatizohej në mjedisin shoqëror edhe atë familjar. Familjarët e tij nuk provuan se lidhjet e tyre me të afërmit ishin shkëputur.

8. Më 28 shkurt 2007, kërkuksi apeloj në Gjykatën e Lartë duke parashtruar të njëjtat arsye për apelim.

9. Më 12 mars 2010, Gjykata e Lartë e kundërshtoi apelimin duke qenë se ai nuk përmbante arsye ligjore sipas parashikimit të nenit 472 të Kodit ët Procedurës Civile.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 5 § 5

10. Kërkuksi ankohej se nuk kishte marrë kompensimin e duhur për paraburgimin e tij. Ai i referohej nenit 5 § 5 dhe nenit 8 të Konventës. Duke marrë në konsideratë natyrën e ankesave të kërkuksit, Gjykata, duke qenë kompetente në interpretimin e fakteve të një çështje mbështetur në ligj, gjykon se problematikat e ngritura në çështjen konkrete duhet të shqyrtohen vetëm nga perspektiva e nenit 5 § 5 të Konventës (krahaso *D.G. kundër Irlandës*, nr. 39474/98, § 110, GJEDNJ 2002-III, dhe *Venskutë kundër Lituanisë*, nr. 10645/08, § 83, 11 dhjetor 2012).

11. Gjykata thekson se neni 5 § 5 respektohet kur është e mundur të kërkohej kompensim për privimin nga liria në situata që bien ndesh me paragrafët 1, 2, 3 ose 4 (shih *Stanev kundër Bullgarisë* {DHM}, nr. 36760/06, § 182, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 2012-I; dhe *Kocamiş dhe Kurt kundër Turqisë*, nr. 227/13, § 13, § 38, 25 janar 2022). E drejta për kompensim e parashikuar në nenin 5 § 5 presupozon se shkelja e njërit prej paragrafëve paraardhës të nenit 5 përcaktohet ose nga një autoritet i brendshëm, ose nga Gjykata (shih *N.C. kundër Italisë* {DHM}, nr. 24952/94, § 49, GJEDNJ 2002-X; dhe *Kerem Çiftçi kundër Turqisë*, nr. 35205/09, § 37, 21 dhjetor 2021). Në çështjen konkrete, gjykata vendase vendosi se paraburgimi i kërkuksit kishte qenë “i padrejtë”, sepse ai ishte liruar prej akuzave ndaj tij, dhe gjithashtu ata kishin theksuar kohën e gjatë të procedurave të cilat kishin rezultuar në lirim të kërkuksit. Duke iu referuar atij konstatimi të gjykatave vendase dhe faktit se kërkuksi kishte qenë në paraburgim për 622 ditë, gjë e cila *prima facie* duket të jetë e tejzgatur, Gjykata pranon se paraburgimi i kërkuksit ishte kundër garancive të nenit 5 § 3 të Konventës. Për pasojë, neni 5 § 5 është i zbatueshëm.

12. Në lidhje me statusin e viktimës të kërkuksit, Gjykata ka vendosur se një vendim apo masë në favor të një kërkuksi në parim nuk është mjaftueshëm për ta privuar kërkuksin nga statusi i tij apo i saj i “viktimës”, kur autoritetet vendase nuk kanë njohur ose shprehimisht ose në substancë , dhe më pas të kenë dhënë kompensim për, shkeljen e Konventës. Statusi i një kërkuksi si viktimë e një shkeljeje të Konventës mund të varet nga kompensimi që është akorduar në nivel vendas në bazë të fakteve për të cilat ai ose ajo ankohet përpara Gjykatës. Përshtatshmëria e zgjidhjes mbetet të vlerësohet në mbështetje të të gjitha rrethanave të çështjes e trajtuar në tërësi (shih *Jurišić kundër Kroacisë*, nr. 29419/17, § 95, 16 janar 2020, me referenca të tjera).

13. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se gjykatat vendase kanë përcaktuar se paraburgimi i kërkuksit ka qenë i padrejtë për shkak të, *inter alia*, tejzgjatjes së tij. Sipas opinionit të Gjykatës, një konstatim i tillë plotëson kushtin e parë të parashikuar në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me nenin 5 § 5 të Konventës.

14. Në lidhje me kushtin e dytë, Gjykata vëren se kërkuksi i ish-in akorduar afërsisht 2, 400 euro si dëmshpërblim për paraburgimin e pajustificuar (shih paragrafin 5 më sipër). Ky kompensim nuk është i paarsyeshëm krahasuar me kompensim që Gjykata do të kishte probabilitet të akordonte në çështje të ngjashme sipas nenit 41 të Konventës (shih *Zehni Doğan kundër Turqisë*, nr. 1515/04, § 36, 2 shkurt 2010; *Đermanović kundër Serbisë*, nr. 48497/06, § 89, 23 shkurt 2010; *Degeratu kundër Rumanisë*, nr. 35104/02, § 69, 6 korrik 2010; *Vasilkoski dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 28169/08, § 70, 28 tetor 2010, *Dzhabarov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 6095/11 dhe 2 të tjerë; §91, 31 mars 2016; *Didov kundër Bullgarisë*, nr.

27791/09; § 48, 17 mars 2016; dhe *Sahakyan kundër Amerikës*, nr. 66256/11, § 40, 10 nëntor 2015). Për këtë arsye, Gjykata gjykon se shuma akorduar kërkuesit mund të konsiderohet e mjaftueshme, dhe prandaj përbën kompensim të drejtë për shkeljet e vuajtura (shih, për parimet përkatëse, *Cocchiarella kundër Italisë* [DHM], nr. 64886/01, §§ 65-107, GJEDNJ 2006 V). Në këtë mënyrë, kërkuesi nuk mund të vijojë të jetë një “viktimë” sipas interpretimit të nenit 34 të Konventës, të shkeljes së pretenduar të së drejtave të tij sipas nenit 5 § 5 të Konventës.

15. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës nuk përputhet *ratione personae* me parashikimet e Konventës sipas kuptimit të nenit 35 § 3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenit 35 § 4.

B. Neni 6 § 1 i Konventës

16. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave përmbledhen në çështjen *Frydlender kundër Francës* ([DHM]), nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000 – VII).

17. Në çështjen konkrete, kohëzgjatja e procedurave në tërësi zgjati katër vite, tre muaj dhe tetëmbëdhjetë ditë, nga të cilat tre vite dhe dymbëdhjetë ditë ishin përpara Gjykatës së Lartë.

18. Për sa ka të bëjë me sjelljen e kërkuesit, nuk ka asgjë që të sugjerojë se ai ka ndikuar në kohëzgjatjen e procedurave.

19. Për sa ka të bëjë me reagimin e gjykatave vendase, nuk pati vonesa në procedura përpara gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit. Megjithatë, procedurat përpara Gjykatës së Lartë mund të duken disi të tejzgjatura.

20. Në lidhje me atë çfarë ishte në rrezik për kërkuesin, Gjykata vëren se pretendimi i tij për kompensim në lidhje me paraburgimin e tij të padrejtë mund të konsiderohet si një çështje e rëndësishme. Procedurat përpara gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit u realizuan pa vonesa dhe e drejta e kërkuesit për kompensim pas miratimit të vendimit të apelit u bë e zbatueshme. Për këtë arsye, procedurat përpara Gjykatës së Lartë nuk ishin më vendimtare për kërkuesin që të merrte kompensimin që i ishte akorduar.

21. Gjykata kishte theksuar se drejtësia në procedura do të vlerësohej duke marrë në konsideratë procedurat në tërësi. Edhe pse kohëzgjatja e procedurave përpara Gjykatës së Lartë mund të duket disi e gjatë, Gjykata vëren se kohëzgjatja e përgjithshme prej katër vitesh, tre muajsh dhe tetëmbëdhjetë ditësh përpara tre niveleve të juridiksionit nuk mund të konsiderohen si të tejzgjatura. Duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave dhe faktin se akordimi i dëmshpërblimit për kërkuesin ishte bërë i formës së prerë, dhe në këtë mënyrë, i zbatueshëm kur Gjykata e Apelit Vlorë la në fuqi vendimin e nivelit të parë, që do të thotë pavarësisht procedurave përpara Gjykatës së Lartë, Gjykata është gati të pranojë se në rrethanat konkrete të çështjes në fjalë kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave ishte në përputhje me kërkesat për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës (krahaso *Süssman kundër Gjermanisë*, nr. 20024/92, 16 shtator 1996; *Krasuski kundër Polonisë*, nr. 61444/00, §§ 57 dhe 58, 14 qershor 2005; dhe *Gassner kundër Austrisë*, nr. 38314/06, §§ 37 dhe 38, 11 dhjetor 2012).

22. Në përputhje me rrethanat, kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E deklaron kërkesën të pranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 10 nëntor 2022.

Olga Chernishova
Zëvendësregjistrare

Andreas Zünd
Kryetar

